



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 941/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha edhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës (AAK) dega në Suharekë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit me nr. 2424A/02D (KVV), për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve dhe manipulimit të votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pa afatshme ankesa e AAK-se dega në Suharekë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 18.11.2013, nga Subjekti politik Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës (AAK) dega në Suharekë, në të cilën pretendon se ka pasur shkelje në vendvotimin nr 2424A/02D në fshatin Duhel të komunes së Suharekës ku AAK-ja ka 178 vota si subjekt në FPR ndërsa kandidatet për asamble komunale nga rradhet e AAK-se kanë 186 vota, pra ka mosperputhje të rezultateve në mes FPR-se dhe FKR-se, Po ashtu edhe nga rradhet e PDK-se ka mosperputhje të rezultateve në mes FPR dhe FRK-se nga e cila PDK-ja ka 89 vota sipas FPR-se ndërsa kandidatet për asamble komunale nga PDK-ja kanë 97 votasipas FRK-se, andaj kërkojmë rinumrimin e e këtij vendvotimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa afatshme

PZAP-i konsideron se ankesa në fjalë është e pa afatshme pasi që neni 105.1 i LZP-së parasheh që ankesat lidhur me administrimin e numrimit në QNR dorzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar. KQZ-ja me datën 14.11.2013 ka bërë publikimin e rezultateve përfundimtare ndërsa pala ankuese, ankesën e ka dorzuar në PZAP me datën 18.11.2013 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 24 orësh për dorëzimin e ankesës në PZAP, prandaj në kuptim të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 105.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr.941 /2013 më datën 18.11.2013



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.